

**PROGRAM PER MENAXHIMIN E  
INTEGRUAR  
TE ZJARRIT BAKTERIAL  
ERWINIA AMYLOVORA**

# **Plotësimi i kuadrit ligjor**

**Ligj per sherbimin fitosanitar**

**Rregullore mbi masat karantinore**

**Regullore e veçante per zjarrin bakterial**

## **Familjarizimi me njohuritë mbi sëmundjen.**

- **Njohja e simptomave (gjate vegjetacionit, ne vjeshte-dimer)**
- **Infektimi dhe përhapja (kushtet e motit, era, insektet, zogjte, veglat e krasitjes, ujitja ne forme shiu ne fidanishte, materiali mbjelles, bujtesit e eger, varjetete qe lulezojne gjate dhe vone).**

## **Monitorimi i sëmundjes**

**Monitorim i vazhdueshem; pemet meme, pemtoret ne prodhim, parqet dhe fidanishtet-prioritet**

# **Detyra ndaj rrezikut**

**Kontroll i importeve (materiali mbjelles)**

**Ç'rrenjosje ne vatrat e reja**

**Ndergjegjesimi dhe pergjegjesia e  
fermereve**

# Parandalimi

\* Zjarri bakterial perben alarm; çdo dyshim duhet te njoftohet ne Sherbimin Fitosanitar te Ministrise Bujqesise, rasti duhet te konfirmohet, vatra e re eleminohet.

\* Bimet bujtese *Rosaceae* duhet te evitohen ne parqet zbukuruese

\* Mbjelljet e reja behen me fidane te çertifikuar per pasterti nga semundja. Inspektim i fidanishteve Qershor-Shtator.

• Inspektimi sistematik (vigjilence, njohje e mire e shenjave te semundjes, kontrolli i pemeve meme, copav bimeve zbukuruese, etj. sidomos ne klime te favorshme per semundjen).

# Masa kufizuese te integruara

- \* Pastrimi i indeve te infektuara me krasitje ne periudhe qetesie
- \* Dezinfektimi i veglave prerese–pas çdo peme, rrjeshti, pemtoreje
- \* Programi i trajtimeve:  
“kur duhet të trajtoj”, “me çfarë të trajtoj?”

**Vendimi merret kur kombinohen keta faktore:**

- Eshtë i pranishëm burimi i infeksionit,
- Bima eshte ne faze te ndjeshme,
- Klima favorizon semundjen.

# Produktet mbrojtese

- Kriprat e bakrit (1 gr Cu metalik/liter uje)
- Streptomicina: 200 ppm.
- Plantomicina 100 ppm.
- Firestop 300 ppm
- Aliete 3000 ppm
- Ekstrakte bimore
- Pseudomonas fluorescens – BlightBan
- Myco-Sin
- Biopro, etj.

# Praktika te mira te rritjes se bimes

- Zgjedhja e nen sharteses dhe mbisharteses rezistente
- Frenimi i rretjes se shpejte te bimes
- Evitimi i pleherave azotike qe e çlirojne ngadale ate.
- Rregullatoret e rritjes (frenues- prohexadione Ca)
- Nxitja e sistemeve mbrojtese ne bime (Bion, Actigard)

# **PROGRAM VJETOR VEPRIMI**





# PROGRAM VJETOR VEPRIMI

## 1. Dhjetor - Shkurt

- Pas rënies së gjetheve, vrojtoni të gjitha pemët në pemtore, bimët strehuese të egra fqinje për kanceret dimërues të pa zbuluar në pemët e reja .Degët e infektuara janë të dallueshme sepse gjethet e prekura mbeten mbi pemë edhe për disa kohë pas rënies natyrale të atyreve normale.
- Krasitni dhe hiqni të gjitha degëzat, lastaret thithake qe dalin nga deget kryesore ose baza e trungut dhe degët e thara ose të vyshkura e të djegura. Shkulini pemët me prekje ne rung; si dhe bimet e egra strehuese te prekura rreth e qark bllokut tuaj. Digjeni të gjithë materialin e prerë të prekur.
- Nëse do të krijoni një pemtore të re dhe planifikoni të blini fidanë, copa etj.vrojtojini me shume kujdes ato. Nëse nuk jeni të sigurtë për rezultatin e vrojtimit dërgoni një kampion për analize në laboratorë të specializuar.
- \* Kryeni trajtime kimike me Lëng bordolez 2-3 % + 1 % vajra minerale.





## 2. Mars - Korrik

- Ndërkohë që pemët çelin gjethe dhe lule, vrojtoni për degë ose luleri të thara ose të vyshkura. Pritini kur i shihni dhe digjini ato.
- Në rast se gjatë vegjetacionit, ka stuhi të forta, shira të rëndë, breshër, ngrica të vonshme etj., që shkaktojnë plagë mbi bimë; trajtimi kimik me Lëng bordolez 1 % i menjëhershëm pas tyre (por jo kur duket dëmi).
- Trajtime të tjera me Lëng bordolez 1 % (ose preparate të tjera bakri në doza ekuivalente). Kujdes,; preparatet e bakrit në disa kultivarë mollësh e dardhësh japin fitotoksicitet, fenomenin e ndryshkut në frutat e rinj.
- Kontrolloni me kujdes për praninë e shenjave të sëmundjes në pemët mëmë nga ku mendoni se do të nxirrni (ose do të blini) sytha për shartim.
- Kontaktoni me Shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve dhe raportoni çdo konstatim të zjarrit bakterial, qofte dhe ne bime te egra strehuese perreth bllokut tuaj.

## **3 Gusht - Nentor**

**\* Vrojtani të gjithë murrizet ose bimët e tjera strehuese të egra rreth qark që herët në Gusht, para se të fillojë ndryshimi natyral i ngjyrës së pjesëve vegetative.**

**Vazhdoni inspektimin e pemëve. Shkulini ato nëse janë të prekura në më shumë se 3 pika të shpërndara në kurorë ose kanë plagët kanceroze të sëmundjes në trung. Digjeni të gjithë materialin drusor të prerë ose të shkukur.**

**Nëse do të mbillni një pemtore të re Janarin që vjen, nëse mundeni, kontrollojini fidanët që do të blini për prekjen nga sëmundja, që tani, kur janë ende në fidanishte.**

**\* Vrojtimi dhe kontrolli i tanishëm duket se është më i sigurtë se një analizë e një kampioni që mund të kryhet gjatë blerjeve në dimër; ai gjithmonë do të jetë i kufizuar rreth kampionit të testuar, që nuk mund të përfaqësojë tërësinë e kulturës.**

## 4 Mbani mend

- Mjetet prerëse duhet të dezinfektohen me solucione dezinfektuese me bazë fenoli 3 % , alkol 70 %, ose 10 % hypochlorit natriumi.
- Mjetet më të mëdha duhet të fërkohen me furcë që përmbajnë dezinfektant për të hequr copëzat e mbetura dhe lëngun e marrë nga bima e prerë.
- Pastroni me kujdes të gjitha veglat në përfundim të ditës së punës, para dezinfektimit përfundimtar.
- Pjesët e prera të drurit lyhen me bojë vaji cilësore ose pastë me preparate bakri në përqëndrim të lartë.

**Kujdes : Të gjithë dezinfektantët e fuqishëm janë të rrezikshëm dhe duhet të punohet me kujdes me ata.**





# **Operacionet per heqien ose pastrimin e lastareve te infektuar**

**•Fillimisht bëni një çveshje të cekët të lëvores deri në anët e ç'ngjyrosura të lëvores. Vrojtoni për indin drunor të ngjyrosur në të kuqe-kafe pikërisht ndën lëvore, duke u zgjeruar anash lëvores së ç'ngjyrosur. Nëse indi drunor i ngjyrosur është present, trajtojeni atë si zjarr bakterial.**

**Tani dezinfektojeni thikën tuaj, dhe :**

**Bëni një prerje të vogël në pjesën e shëndoshë disa cm më poshtë kufirit të lëvores së ç'ngjyrosur. Vazhdoni të prisni në drejtim të zonës së sëmurë për të përcaktuar madhësinë e ngjyrimit.**

**Tani dezinfektoni thikën tuaj, dhe:**

**Në se diametri i degës është më i vogël se 25 mm, priteni atë 30 cm ndën kufirin e indit të ngjyrosur. Në se diametri është më i madh se 25 mm priteni atë 60 cm ndën kufirin e indit të ngjyrosur. Në se pjesa e ngjyrosur është në trung ose në degën kryesore por brënda një distance prej 60 cm nga trungu; shkuleni të gjithë pemën ose shkurren,**

**Tani digjeni të gjithë materialin e infektuar ; dhe dezinfektojeni thikën tuaj përsëri. (Përdorni solucionet e përmendura më sipër).**